



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

Nr. 1931/2 Prot.

Tiranë, më 18.06.2025

V E N D I M

Nr. 32 datë. 18.06.2025

**“PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT, VLERËSIMIT,
PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË KANDIDATURËS SË Z. JULIS ZEBI PËR
SHKAK TË TËRHEQJES NGA KANDIDIMI PËR INSPEKTOR JOMAGJISTRAT
TË SHPALLUR MË DATË 27.05.2024”**

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Znj. Elena Pelushi – Kryetar

Znj. Lindita Ziguri – Anëtar

Znj. Joana Sorraj - Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Zonje Sheqizi

Znj. Eljona Bylykbashi

Znj. Amanta Jasa

Në mbledhjen e datës 18.06.2025, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit për inspektor jomagjistrat: Z. Julis Zebi

OBJEKTI: Tërheqje nga kandidimi për Inspektor jomagjistrat

Komiteti pasi u njoh me aktet si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 27.05.2024, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 4 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 74 datë 26.06.2024 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 26.06.2024, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 02.07.2024, ku vendosi për shqyrtimin e dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit".
4. Z. Julis Zebi, si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin nëpërmjet kërkesës me nr. 1815 prot., datë 26.06.2024 për vendin vakant të Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës bazuar në detyrimet ligjore, të përcaktuara nga neni 209, neni 211, pika 2, të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin

e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", si dhe urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë". Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

5. Në datën 10.07.2024, kandidati Julis Zebi, është paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatis të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.
6. Në datën 16.07.2024 kandidati Julis Zebi ka depozituar pranë sekretariatit teknik formularët e deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.
7. Kandidati Julis Zebi ka njoftuar nëpërmjet "Njoftimit për tërheqje nga procedura e kandidimit për pozicionin Inspektor jo magjistrat", Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për tërheqjen nga procedura e kandidimit për pozicionin e Inspektorit jomagjistrat. Kërkesa e kandidatis me nr. 1914 prot., datë 17.06.2025, administruar në dosjen e kandidimit nga Komiteti pas përfundimit të mbledhjes së zhvilluar në të njëjtën ditë dhe datë të depozitimit të kërkesës.
8. Në lidhje me rastin e tërheqjes nga kandidimi, në pikën 7 të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", parashikohet se:

"7. Kandidati jo magjistrat ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Inspektorin. Pas këtij njoftimi, Inspektori vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatis jomagjistrat. Akti i Inspektorit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatis jomagjistrat dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë."

9. Në përfundim të njohjes së Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve me materialet që përmban dosja e kandidatis Julis Zebi deri në këtë fazë dhe në mënyrë të veçantë shprehjen e vullnetit të tij, në zbatim të pikës 7 dhe 24, të vendimit nr. 536, datë

25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", është përgatitur relacioni që përshkruan procedurën e zhvilluar deri në momentin e tërheqjes nga kandidimi dhe projektakti mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit jomagjistrat të tërhequr.

10. Në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Kryetari i Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve ka thirrur mbledhjen e Komitetit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 18.06.2025. Në mbledhje është përfshirë çështja me objekt tërheqjen nga kandidimi të z. Julis Zebi për vendin vakant për Inspektor, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në datën 27.05.2024.
11. Në mbledhjen e Komitetit, pasi secili prej anëtarëve u njoh me aktet e administruara në dosjen që lidhet me kandidimin e z. Julis Zebi, si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi, u arrit në konkluzionin se:

II. Vlerësimi i Komitetit

12. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të sipërcituara si dhe bazuar në gjendjen që janë aktet që lidhen me ndjekjen e procedurave për vendin vakant për Inspektor jomagjistrat të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në datën 27.05.2024, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për përfundimin e procedurës administrative që lidhet me kandidatin Z. Julis Zebi
13. Në nenin 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar parashikohet se:

"2. Inspektorët e tjerë emërohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në bazë të një procedure përzgjedhëse dhe konkurruese të hapur dhe të planifikuar. Jo më vonë se 3 muaj nga krijimi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Lartë miraton rregulla më të hollësishme për procedurën e përzgjedhjes, konkurrimit dhe emërimit të inspektorëve jomagjistratë. Rregullat e miratuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë zbatohen, për aq sa është e mundur, me rregullat e ligjit "Për nëpunësin civil".
14. Në zbatim të nenit 209 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, në përfundim të afatit të caktuar të shpalljes "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes në pozicionin vakant Inspektor jomagjistrat pranë Inspektorit

të Lartë të Drejtësisë", Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, pasi ka administruar dokumentacionin e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë pozicion, ka filluar procedurën e verifikimit të kandidaturave për plotësimin e kushteve dhe kriterëve të kandidimit që parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji.

15. Ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, nuk parashikon në mënyrë të shprehur rastin e tërheqjes nga kandidimi dhe mënyrën e disponimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në raste të tilla.

16. Por, nga ana tjetër, ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, në pikën 2 të nenit 209, parashikon se:

"2. Inspektorët e tjerë emërohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas këshillimit me Komitetin e Emërimit dhe të Vlerësimit të Inspektorëve, në bazë të një procedure përzgjedhëse të hapur, konkurruese dhe të planifikuar, në analogji, për atë që është e mundur, me rregullat e ligjit "Për nëpunësin civil".

17. Bazuar në këtë detyrim dhe delegim ligjor për të miratuar, në bazë dhe për zbatim të ligjit, rregulla më të detajuara normative, konkretisht në vendimin nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", në pikën 7 të tij, parashikohet se:

"7. Kandidati jomagjistrat ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Inspektorin. Pas këtij njoftimi, Inspektori vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit jomagjistrat. Akti i Inspektorit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit jomagjistrat dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë."

Gjithashtu në pikën 24, të vendimit nr. 536 datë 25.7.2019 "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", parashikohet se:

"24. Kur kandidati jo magjistrat njofton tërheqjen nga kandidimi, Inspektori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projektaktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit jomagjistrat të tërhequr. "

18. Nga aktet që përmban dosja e kandidimit, rezulton që kandidati Julis Zebi, ka paraqitur një kërkesë për heqje dorë nga kandidimi për pozicionin vakant për Inspektor jomagjistrat

pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me kërkesën nr.1914 prot., datë 17.06.2025. Ky komunikim gjendet i administruar në dosjen e kandidatit.

19. Komiteti vlerëson të rregullt në aspektin e qartësisë së vullnetit të shprehur prej kandidatit për tërheqjen nga kandidimi, shkresën e paraqitur për këtë qëllim nga kandidati Julis Zebi.
20. Komiteti vlerëson që shprehja e interesit dhe kandidimi për plotësimin e vendeve vakante që krijohen për Inspektor jomagjistrat pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një e drejtë, e cila ushtrohet nga kandidatët ekskluzivisht mbi vullnetin individual të tyre, duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e kandidimit që parashikon Kushtetuta dhe ligji.
21. Në rast se personi që kandidon, në çdo kohë e gjendje të procedurës, shpreh vullnetin për të mos vijuar më tej me kandidimin për plotësimin e vendit vakant që krijohet për Inspektor jomagjistrat pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, atëherë nuk ka më vend të vijnë procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar, pikës 7 dhe 24 të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës së z. Julis Zebi, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për pozicionin Inspektor jomagjistrat pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Në zbatim të pikës 7, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", ky vendim i njoftohet kandidatit Julis Zebi.

3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën kompetente, brenda afatit ligjor.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

ANËTAR

Lindita Ziguri



KRYETAR

Elena Pelushi



ANËTAR

Joana Sorraj

